




**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN

# VROJTIMI I IMPAKTIT MBI BIZNESIN

## Raporti Përfundimtar

Ky raport u përgatit nga **IDRA** për **Projektin e Marrëveshjes Prag të Sfidës së Mijëvjeçarit**, administruar nga **USAID**



Institute for  
**D**evelopment  
**R**esearch and  
**A**lternatives

*Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet zyrtare të Projektit të Marrëveshjes Prag të Sfidës së Mijëvjeçarit, USAID ose Qeverisë Amerikane.*

**Raporti Përfundimtar**  
**Vrojtimi i Impaktit mbi Biznesin**

Përgatitur për: **Projektin e Marrëveshjes Prag të Sfidës së Mijëvjeçarit**, administruar nga **USAID**

Përgatitur nga: **Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi - IDRA, Tiranë, SHQIPËRI**

**Tiranë, 2008**

## Përmbajtja

<b>Tabela dhe Grafikë</b>	<b>4</b>
<b>Përmbledhje</b>	<b>7</b>
Administrata Tatimore	7
Prokurimi Publik	8
Regjistrimi i Biznesit	9
Interneti dhe Përdorimi i Shërbimeve Bankare përmes Internetit	9
<b>Të Dhënat dhe Metodologjia</b>	<b>10</b>
1. Objektivat e Vrojtimt	10
2. Çështjet e Trajtuara	10
3. Rezultatet e Paraqitura	11
4. Përshkrimi i Shembullit	11
<b>Biznesi dhe Interneti</b>	<b>16</b>
<b>Sistemi Tatimor</b>	<b>23</b>
<b>Prokurimi Publik</b>	<b>39</b>
<b>Regjistrimi i Biznesit</b>	<b>53</b>

*Tabela dhe Grafikë*

Tabela 1: Shembulli sipas qyteteve.....	12
Grafiku 1: Shembulli sipas sektorëve.....	13
Grafiku 2: Shembulli sipas pronësisë.....	13
Grafiku 3: Shembulli sipas formës organizative të kompanisë.....	14
Grafiku 4: Shembulli sipas madhësisë së kompanisë.....	14
Grafiku 5: Gjinia e të intervistuarve.....	15
Grafiku 6: Gjinia e të intervistuarve sipas pozicionit.....	15
Grafiku 7: A keni internet dhe email në zyrat tuaja?.....	16
Grafiku 8: A keni internet dhe email në zyrat tuaja? - 2008 TPM ndaj 2008 ZTT.....	17
Grafiku 9: A keni internet dhe email në zyrat tuaja? - sipas madhësisë së kompanisë.....	17
Grafiku 10: Lloji lidhjes së internetit.....	18
Grafiku 11: A keni intranet në zyrat tuaja?.....	18
Grafiku 12: A keni intranet në zyrat tuaja - 2007 TPM ndaj 2008 TPM.....	19
Grafiku 13: Përdorimi i intranetit midis bizneseve të madhësive të ndryshme.....	19
Grafiku 14: Arsyet që nuk kanë akses të plotë në internet – përgjigje e shumëfishtë.....	20
Grafiku 15: Përdorimi i shërbimeve bankare përmes internetit.....	20
Grafiku 16: Përdorimi i shërbimeve bankare përmes internetit - 2007 TPM ndaj 2008 TPM.....	21
Grafiku 17: Përdorimi i shërbimeve bankare përmes internetit – sipas madhësisë së kompanisë.....	21
Grafiku 18: Përdorimi i shërbimeve bankare përmes internetit – “në Tiranë” ndaj “Jo në Tiranë” dhe 2007 TPM ndaj 2008 TPM.....	22
Grafiku 19: Burimet kryesore të informacionit mbi sistemin tatimor.....	23
Grafiku 20: Burimet kryesore të informacionit mbi sistemin tatimor - “Tiranë” ndaj “Jo në Tiranë”.....	24
Grafiku 21: Sa shpesh e përdorni faqen e internetit të DPT?.....	24
Grafiku 22: Burimet kryesore të informacionit mbi sistemin tatimor - 2007 TPM ndaj 2008 TPM.....	25
Grafiku 23: Si do ta vlerësonit cilësinë e faqes së internetit të DPT?.....	25
Grafiku 24: A e keni përdorur faqen e internetit të DPT gjatë tre muajve të fundit?.....	26
Grafiku 25: Mesatarisht në muaj, sa shpesh kontaktoni me zyrën e taksave?.....	26
Grafiku 26: Vlerësimi i marrëdhënieve me sistemin tatimor gjatë gjashtë muajve të fundit.....	27
Grafiku 27: Vlerësimi i marrëdhënieve me sistemin tatimor - 2007 TPM ndaj 2008 TPM.....	28
Grafiku 28: “Përdorimi i faqes së DPT gjatë tre muajve të fundit” ndaj “Ekzistenca në kohën e duhur e informacionit”.....	29
Grafiku 29: “Përdorimi i faqes së DPT gjatë tre muajve të fundit” ndaj “Cilësia e informacionit”.....	30
Grafiku 30: Zakonisht si e merrni informacionin në lidhje me gjendjen e llogarive tuaja tatimore? – “Tiranë” ndaj “Jo në Tiranë”.....	30
Grafiku 31: Zakonisht si e merrni informacionin në lidhje me gjendjen e llogarive tuaja tatimore?.....	31

Grafiku 32:	Zakonisht si e merrni informacionin në lidhje me gjendjen e llogarive tuaja tatimore? - 2007 TPM ndaj 2008 TPM.....	31
Grafiku 33:	Koha e shpenzuar për përgatitjen, dorëzimin e deklaratave tatimore mujore dhe pagesat e tyre.....	32
Grafiku 34:	Koha e shpenzuar për përgatitjen, dorëzimin e deklaratave tatimore mujore dhe pagesat e tyre - sipas madhësisë së kompanisë.....	32
Grafiku 35:	Koha e shpenzuar për përgatitjen, dorëzimin e deklaratave tatimore mujore dhe pagesat e tyre - 2007 TPM ndaj 2008 TPM.....	33
Grafiku 36:	“Përdorimi i faqes së DPT gjatë tre muajve të fundit” ndaj “Koha e shpenzuar për përgatitjen dhe dorëzimin e deklaratave tatimore mujore”.....	34
Grafiku 37:	Gjatë një viti të caktuar, sa shpesh një kompani si e juaja duhet të bëjë dhurata kur kanë të bëjnë me tatimet dhe mbledhjen e tyre?.....	35
Grafiku 38:	Koha e shpenzuar në vit për përgatitjen dhe dorëzimin e Bilancit Vjetor.....	36
Grafiku 39:	Koha e shpenzuar për përgatitjen dhe dorëzimin e Bilancit Vjetor - 2007 TPM ndaj 2008 TPM.....	36
Grafiku 40:	Besimi në aftësitë e stafit në:.....	37
Grafiku 41:	“Përdorimi i faqes së internetit të DPT gjatë tre muajve të fundit” ndaj “Besimi në aftësitë e stafit për kuptimin e ligjeve dhe procedurave tatimore”.....	38
Grafiku 42:	“Përdorimi i faqes së internetit të DPT gjatë tre muajve të fundit” ndaj “Besimi në aftësitë e stafit për të llogaritur detyrimin tatimor”.....	38
Grafiku 43:	A keni dëgjuar për mundësinë e kryerjes së pagesave tatimore përmes internetit?.....	39
Grafiku 44:	A ka marrë pjesë kompania juaj në trajnime për deklarimin tatimor përmes internetit, të ofruara nga projekti?.....	39
Grafiku 45:	“Përdorimi i faqes së internetit të DPT në tre muajt e fundit” ndaj “Pjesëmarrja në trajnime për deklarimin tatimor përmes internetit, të ofruar nga projekti”.....	40
Grafiku 46:	Numri gjithsej i pagesave të taksave, të bëra gjatë vitit të kaluar, përfshirë tatimin mbi të ardhurat, TVSH dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.....	40
Grafiku 47:	Përqindja e të ardhurave të kompanisë që vjen nga shitjet e bëra agjencive shtetërore?.....	41
Grafiku 48:	A ka marrë pjesë ndonjëherë kompania juaj në një tender publik?.....	42
Grafiku 49:	Në sa tendera publike ka marrë pjesë kompania juaj gjatë 3 viteve të fundit?.....	42
Grafiku 50:	Burimet e informimit mbi procedurat e prokurimit publik - “Tiranë” ndaj “Jo në Tiranë” (n=297) – përgjigje e shumëfishtë.....	43
Grafiku 51:	Burimet e informimit mbi procedurat e prokurimit publik - 2007 TPM ndaj 2008 TPM - përgjigje e shumëfishtë.....	43
Grafiku 52:	A keni dëgjuar për mundësinë e prokurimit përmes internetit.....	44
Grafiku 53:	A ka marrë pjesë kompania juaj në ndonjë prokurim përmes internetit.....	44
Grafiku 54:	A keni dëgjuar për Zyrën e Avokatit të Prokurimit?.....	45

Grafiku 55: Nga cili burim keni dëgjuar për Zyrën e Avokatit të Prokurimit? – përgjigje e shumëfishtë.....	45
Grafiku 56: Planifikoni të merrni pjesë në një tender publik gjatë 12 muajve të ardhshëm?.....	46
Grafiku 57: “Pjesëmarrja në prokurim elektronik” ndaj “Planifikoj të marrë pjesë në tender publik në të ardhmen”.....	46
Grafiku 58: Gadishmëria për dorëzimin e dokumentave të tenderave përmes internetit - 2007 TPM ndaj 2008 TPM.....	47
Grafiku 59: “Pjesëmarrja në prokurim elektronik” ndaj “Gadishmëria për prokurimin elektronik”.....	47
Grafiku 60: Si do të dëshironit ta merrnit informacion mbi sistemin e prokurimit publik në të ardhmen? - 2007 TPM ndaj 2008 TPM - përgjigje e shumëfishtë.....	48
Grafiku 61: Përqindja e vlerës së kontratës që duhet paguar zakonisht në formë dhuratash me qëllim që të fitohet kontrata.....	49
Grafiku 62: “Pjesëmarrja në prokurim elektronik” ndaj “Përqindja e vlerës së kontratës, paguar në formë dhuratash me qëllim fitimin e kontratës”.....	49
Grafiku 63: Gjatë një viti të caktuar, sa shpesh i duhet një firme të ngjashme me tuajën të bëjë dhurata për të fituar kontrata shtetërore?.....	50
Grafiku 64: A keni marrë pjesë në trajnim për ligjin e ri të prokurimit publik?.....	50
Grafiku 65: A keni marrë pjesë në trajnim për prokurimin elektronik?.....	51
Grafiku 66: “Pjesëmarrja në prokurim elektronik” ndaj “Pjesëmarrja në trajnim për ligjin e ri të prokurimit publik”.....	51
Grafiku 67: “Pjesëmarrja në prokurim elektronik” ndaj “Pjesëmarrja në trajnim për prokurimin elektronik”.....	52
Grafiku 68: Përse nuk planifikoni të merrni pjesë në tendera publike? - përgjigje e shumëfishtë.....	52
Grafiku 69: Gadishmëria për regjistrimin e biznesit përmes internetit.....	53
Grafiku 70: Gadishmëria për regjistrimin e biznesit përmes internetit - 2007 TPM ndaj 2008 TPM.....	53
Grafiku 71: A keni dëgjuar për QKR?.....	54
Grafiku 72: Sa do të ishit të gatshëm të paguani për çdo transaksion që QKR të vazhdojë të kryerjë shërbimin brenda një dite?.....	54

## I Përmbledhje

Raporti i mëposhtëm paraqet gjetjet e Vrojtimet Impakti mbi Biznesin, i realizuar gjatë muajit Korrik 2008. Ky është raporti i dytë i këtij lloji pas Vrojtimet të Nevojave të Biznesit, realizuar në muajin Korrik 2007.

Vrojtimi i Nevojave të Biznesit 2007 krijoi një matës bazë të përdorimit dhe efektivitetit të shërbimeve publike ekzistuese në tre fushat e projektit: administratën tatimore, prokurimin publik dhe regjistrimin e biznesit. Gjithashtu, ai vlerësoi edhe gadishmërinë e bizneseve ndaj shërbimeve të reja elektronike të planifikuara për tu aplikuar në këto tre fusha.

Vrojtimi i Impaktit mbi Biznesin 2008 u krye për të matur shkallën e përdorimit dhe efektivitetin e shërbimeve të reja, për të vlerësuar ndryshimet në kënaqësinë e përdoruesve të shërbimeve të ofruara nga Qeveria Shqiptare në tre komponentët, për të matur progresin kundrejt treguesve të projektit dhe identifikuar marrëdhëniet me qëllim që, aty ku është e mundur, t'ia kontribuojë ndikimin pozitiv ndërhyrjeve të projektit.

Universi i shembullit përfshiu a) 1,032 tatimpagues të regjistruar në Zyrën e Tatimpaguesve të Mëdhenj (TPM) dhe b) 6,868 tatimpagues subjekt i TVSH-së, të regjistruar në Zyrën e Tatimpaguesve të Tiranës (ZTT), të cilët janë në përgjithësi biznese të mesme (xhiro vjetore të paktën 8 milionë lekë). Një kampion prej 300 biznesesh u përzgjedh rastësisht, i shpërndarë në mënyrë të barabartë midis këtyre dy grupeve. Gjatë këtij vrojtimi u intervistuan 297 biznese.

Disa nga gjetjet kryesore të këtij vrojtimi janë:

### *Administrata Tatimore*

- 55% e bizneseve kanë identifikuar faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve si burimin kryesor të informacionit mbi sistemin tatimor. Bizneset jashtë Tiranës vazhdojnë të konsiderojnë vizitat që kryejnë pranë zyrave të tatimeve në qytetet e tyre si burimin kryesor të informacionit.
- Ka një përmirësim në të gjitha aspektet e ndërveprimit të bizneseve me sistemin tatimor në vitin 2008 krahasuar me vrotimin e vitit 2007. 67% e bizneseve TPM e vlerësuan “shumë mirë” ose “mirë” trajtimin e tyre në përgjithësi, krahasuar me 42% në vrotimin 2007, me një rritje prej 25%.

Po kështu, përqindja e bizneseve që e vlerësuan “shumë mirë” dhe “mirë” cilësinë e informacionit është rritur nga 36% në 54%, ndërsa vlerësimi për ekzistencën në kohën e duhur të informacionit është rritur nga 37% në 51%.

- 59% e bizneseve që morrën pjesë në vrojtim thanë se punonjësit e tyre shpenzojnë mesatarisht një ditë ose më më pak për të përgatitur dhe dorëzuar deklaratat tatimore. 54% e bizneseve TPM thanë se shpenzojnë vetëm një ditë ose më pak në 2008, krahasuar me 24% që thanë të njëjtën gjë në 2007.
- Përqindja e bizneseve TPM që shpenzojnë më pak se një muaj për përgatitjen e bilancit vjetor është rritur nga 59% në 2007 në 81% në 2008.
- 90% e bizneseve që morën pjesë në vrojtim thanë se kanë bërë më pak se 49 pagesa tatimore gjatë vitit të kaluar, përfshirë tatimin mbi fitimin, TVSH dhe kontributin për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.
- 19% e bizneseve të intervistuar thanë se një firmë e ngjashme me të tyren do të duhej të bënte dhuratë ose pagesë informale kur ato kanë të bëjnë me tatimet dhe mbledhjen e tyre gjatë një viti të caktuar.

### **Prokurimi Publik**

- 30% e bizneseve të vrotjuara thanë se një pjesë e të ardhurave të tyre vjen nga shitjet që u bëjnë agjencive shtetërore. 36% e bizneseve thanë se kanë marrë pjesë në një tender publik të paktën një herë. Nga këto, 94% kanë marrë pjesë të paktën një herë gjatë tre viteve të fundit dhe 56% kanë marrë pjesë në 5 ose më shumë tendera publikë.
- Faqja e internetit e APP vazhdon të mbetet burimi kryesor i informacionit për bizneset e vendosura në Tiranë (68%), pasuar nga buletini i APP (31%). 46% e bizneseve jashtë Tiranës përdorin në të njëjtën masë si vizitat pranë zyrave shtetërore, ashtu edhe faqjen e internetit të APP.
- 89% e bizneseve që kanë marrë pjesë në tendera gjatë tre viteve të shkuara kanë dëgjuar mbi mundësinë e dorëzimit të dokumentave të tenderave përmes internetit. Gjithsesi, vetëm 19% e tyre i kanë paraqitur dokumentat në mënyrë elektronike.

- 73% e bizneseve të vrojtuar kanë dijeni për ekzistencën e Zyrës së Avokatit të Prokurimeve.
- Faqja e internetit e APP është burimi më i preferuar i informacionit për bizneset që planifikojnë të marrin pjesë në tendera.
- Rreth 25% e bizneseve që mendojnë të marrin pjesë në tender gjatë 12 muajve të ardhshëm thanë se kanë marrë pjesë në trajnime mbi ligjin e ri të prokurimit publik dhe prokurimin përmes internetit.

### **Regjistrimi i Biznesit**

- 91% e bizneseve janë “shumë të gatshëm” ose “disi të gatshëm” për idenë e regjistrimit të biznesit përmes internetit.
- Shumica dërrmuese e të intervistuarve, 96%, thanë se kanë dëgjuar mbi Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR).
- Shumica e bizneseve të intervistuar (56%) janë të gatshëm të paguajnë 200 lekë ose më shumë për transaksion, për të bërë të mundur vazhdimësinë e shërbimit brenda ditës të QKR-së.

### **Interneti dhe Përdorimi i Shërbimeve Bankare përmes Internetit**

- Të marrë të gjithë sëbashku, 84% e bizneseve të intervistuar në vërtetimin 2008 thanë se kanë akses të plotë në internet. Për grupin e bizneseve, tatimpagues të mëdhenj ka një rritje të lehtë nga 84% në vërtetimin 2007 në 87% në nën-grupin e tatimpaguesve të mëdhenj të vërtetimit 2008. Për nën-grupin e tatimpaguesve subjekt të TVSH-së në vërtetimin 2008 TTO, 81% e bizneseve thanë se kanë akses në internet.
- Përdorimi i shërbimeve bankare përmes internetit, nga bizneset jashtë Tiranës, ka pësuar një rritje me 14% në krahasim me vitin e kaluar. Ky vërtetim tregon se shërbimet bankare përmes internetit përdoren në të njëjtën masë si nga bizneset e vendosura në Tiranë, ashtu dhe ato jashtë Tiranës.

## II Të Dhënat dhe Metodologjia

### *1. Objektivat e Vrojtimit*

Vrojtimi i Impaktit mbi Biznesin u realizua nga IDRA bazuar në objektivat e mëposhtme:

- Të vlerësojë shkallën e përdorimit dhe efektivitetin e shërbimeve të reja elektronike të ofruara nga Qeveria Shqiptare me mbështetjen e projektit të Marrëveshjes Prag të Sfidës së Mijëvjeçarit.
- Të masë progresin e arritur kundrejt treguesve të projektit në përbushjen e nevojave të biznesit dhe të përcaktojë se ku janë të nevojshme përmirësimet në të ardhmen.

Vrojtimi përfshiu bizneset Tatimpagues të Mëdhenj si edhe bizneset, subjekt i TVSH-së, të vendosur në Tiranë. Një pjesë e bizneseve Tatimpagues të Mëdhenj janë intervistuar edhe në vrojtimin e Nevojave të Biznesit, realizuar në vitin 2007.

### *2. Çështjet e Trajtuara*

Instrumenti i vrojtimit ishte një pyetësor standard, i hartuar nga IDRA në bashkëpunim me Projektin e Marrëveshjes Prag të Sfidës së Mijëvjeçarit. Pyetjet trajtuan disa çështje teknike dhe janë grupuar në përputhje me tre komponentet e projektit:

1. Administrata Tatimore
2. Prokurimi Publik
3. Regjistrimi i Biznesit

Pyetësi u hartua bazuar në instrumentin e përdorur në Vrojtimin e Nevojave të Biznesit të vitit 2007, i modifikuar në disa aspekte teknike të cilat duhet të vlerësoheshin dhe të mateshin. Duke qenë se tipari i përbashkët i çështjeve të përmendura më lart është qeverisja elektronike, një seksion i veçantë në fillim të pyetësorit trajton kapacitetet në IT dhe shkallën e lidhjes me internet të bizneseve.

### 3. Rezultatet e Paraqitura

Rezultatet e paraqitura në këtë raport janë kryesisht në formën e:

- 1) Frekuencave
- 2) Kryqëzime të vlerave

Variablat më të përdorur për kryqëzimet e vlerave janë si më poshtë:

- 1) **Madhësia e biznesit** - e shprehur në numrin e punonjësve që ata deklarojnë;
- 2) **Vendndodhja e biznesit** - bizneset e vrojtura janë të ndara në dy grupe: biznese të vendosura në Tiranë dhe biznese të vendosura jashtë saj (në qytetet të tjera të Shqipërisë);
- 3) **Koha e vrojtimit** - ky raport përmban krahasime midis rezultateve të Vrojtimin të Nevojave të Biznesit realizuar në 2007 dhe rezultateve për nëngrupin e Bizneseve Tatimpagues të Mëdhenj të vrojtuar në 2008, me qëllim që të matet progresi;
- 4) **Përdorimi i faqes së internetit të DPT** - për disa kryqëzime të vlerave në pyetjet lidhur me tatimet, bizneset e intervistuar janë ndarë në ata që e kanë përdorur faqen e internetit të DPT gjatë tre muajve të fundit dhe ata që nuk e kanë përdorur – kjo ofron tregues të impaktit të projektit, për faktin se faqja e internetit është ridizenjuar nga projekti dhe është tashmë mjete kryesor i komunikimit të DPT me tatimpaguesit;
- 5) **Pjesëmarrja në prokurimin përmes internetit** - për disa nga kryqëzimet e vlerave në pyetjet për prokurimin, bizneset e intervistuar janë ndarë në ata që kanë marrë pjesë në prokurimin elektronik dhe ata që nuk kanë marrë pjesë.

### 4. Përshkrimi i Shembullit

Ndërtimi i përgjithshëm i shembullit u bazua në listën e Tatimpaguesve të Mëdhenj (TPM) dhe atyre bizneseve të vendosur në Tiranë që paguajnë TVSH, të siguruar nga zyrat përkatëse. Në këto zyra janë regjistruar përkatësisht 1,032 dhe 6,868 kompani. Lista u pastrua për të përjashtuar një numër institucionesh që nuk janë biznese.

U ndërtuan dy nën-shembuj, duke përzgjedhur 150 kompani nga secila listë. Për grupin e Tatimpaguesve të Mëdhenj, kompanitë u ndanë sipas vendndodhjes së tyre gjeografike. Për përzgjedhjen e secilit nën-shembull u ndoq procedura e përzgjedhjes rastësore sistematike. Gjithashtu, u hartuan edhe dy lista shtesë, për tu përdorur në rast refuzimesh apo kur bizneset nuk mund të gjendeshin. Për shkak të problemeve gjatë punës në terren për të gjetur bizneset e Tiranës që janë subjekt i TVSH-së, u bë një modifikim i shembullit për këtë grup biznesesh. Sidoqoftë, shembulli mbeti statistikiisht përfaqësues, me tolerancë gabimi 5.5% dhe interval besueshmërie 95%.

Vrojtimi u realizua përmes intervistave ballë për ballë. Të intervistuarit e synuar përfshinë menaxherët e nivelit të lartë të biznesit (Drejtor Ekzekutiv, Pronar, Menaxher i Përgjithshëm, dhe Drejtor ose Shef Finance).


Shembulli sipas shpërndarjes gjeografike paraqitet si më poshtë:

**Tabela 1: Shembulli sipas qyteteve**

	Frekuenca	Përqindja
Tiranë	237 (147 ZTT + 90 TPM)	80
Durrës	18	6
Fier	10	3
Elbasan	7	2
Korçë	6	2
Shkodër	6	2
Vlorë	6	2
Lushnjë	3	1
Berat	3	1
Lezhë	1	1
Gjithsej	297	100


80% e bizneseve të intervistuar janë të vendosur në Tiranë, ku përfshihen 90 biznese nga grupi i Tatimpaguesve të Mëdhenj dhe 147 nga Zyra e Tatimpaguesve të Tiranës. I dyti renditet Durrësi me 6%, pasuar nga Fieri me 3% dhe qytetet e tjera me më pak se 3% të shembullit. Të gjitha bizneset jashtë Tiranës janë tatimpagues të mëdhenj.

**Grafiku 1: Shembulli sipas sektorëve (n=297)**




Kompanitë e përfshira në veprimtaritë e tregtisë dhe shërbimeve përbëjnë pak më shumë se 60% të shembullit.

**Grafiku 2: Shembulli sipas pronësisë (n=297)**




Pjesa më e madhe e kompanive të intervistuar, 84%, janë kompani vendase, 7% janë të huaja dhe 6% përfaqësojnë kompanitë e përbashkëta. Kompanitë shtetërore përbëjnë vetëm 1% të shembullit.

**Grafiku 3: Shembulli sipas formës organizative të kompanisë (n=297)**



Forma më e zakonshme e organizimit të kompanive të intervistuar është “kompani me përgjegjësi të kufizuar”, që përbëjnë 85% të shembullit. Kompanitë aksionere janë forma e dytë më e zakonshme, me 11%.


**Grafiku 4: Shembulli sipas madhësisë së kompanisë (n=297)**



60% e kompanive të intervistuar kanë 20 ose më pak punonjës, ndërkohë që 29% punësojnë 21-80 vetë. Vetëm 10% e kompanive të intervistuar kanë mbi 80 të punësuar. Sipas standardeve europiane, 89% e kompanive të intervistuar nga Zyra e TPM do të klasifikoheshin si ndërmarje të vogla dhe të mesme (më pak se 80 punonjës).


Duke qenë se numri i të vetë-punësuarve ishte vetëm 4, ata janë bashkuar me grupin e kompanive me “1-5 punonjës”, që përfaqëson kompanitë e vogla (nga numri i punonjësve).

**Grafiku 5: Gjinia e të intervistuarve (n=297)**



54% e të intervistuarve (menaxherët e lartë të kompanisë) janë femra. Pjesa më e madhe e tyre janë në pozicionin e Shefes së Financës (77% e të gjithë të intervistuarve që kanë këtë pozicion). 14% e Drejtuesve Ekzekutiv/ President janë femra.


**Grafiku 6: Gjinia e të intervistuarve sipas pozicionit**



### III Biznesi dhe Interneti


Si edhe në vërtetimin e vitit 2007, në fillim të pyetësorit, bizneseve iu bënë disa pyetje lidhur me internetin dhe përdorimin e tij. Këto pyetje shërbyen edhe si filtër për seksionet pasardhëse të tatimeve, prokurimit publik dhe regjistrimit të biznesit në lidhje me përdorimin apo gadishmërinë ndaj shërbimeve të qeverisjes elektronike, të ofruara kohët e fundit nga projekti.

**Grafiku 7:A keni internet dhe email në zyrat tuaja? (n=297)**




84% e të gjithë kompanive të intervistuar thënë se ato kanë akses të plotë në internet në zyrat e tyre. Vetëm 13% e bizneseve të intervistuar nuk përdorin as internetin, as e-mail.

**Grafiku 8: A keni internet dhe email në zyrat tuaja?  
- 2008 TPM ndaj 2008 ZTT**




Ka një rritje të lehtë në përqindjen e bizneseve tatimpagues të mëdhenj që kanë akses të plotë në internet, nga 84% në 2007 në 87% në vërtetimin e 2008. 81% e tatimpaguesve të Tiranës (pa përfshirë tatimpaguesit e mëdhenj) kanë lidhje interneti në zyrat e tyre.

**Grafiku 9: A keni internet dhe email në zyrat tuaja?  
- sipas madhësisë së kompanisë (n=297)**




Rezultatet tregojnë se sa më i madh biznesi, aq më e madhe është mundësia e bizneseve për të pasur akses të plotë në internet në zyrat e tyre.

**Grafiku 10: Lloji lidhjes së internetit (n=250)**




Nga bizneset që thanë se kanë lidhje interneti, afërsisht 70% kanë lidhje me shpejtësi të lartë (ADSL/kabëll, Antenë apo Satelit). Lloji më i zakonshëm i lidhjes është ADSL/kabëll (52%).

**Grafiku 11: A keni intranet në zyrat tuaja? (n=250)**




63% e bizneseve që kanë akses në internet thanë se kanë edhe intranet në zyrat e tyre.

**Grafiku 12: A keni intranet në zyrat tuaja - 2007 TPM ndaj 2008 TPM**




Krahasimi i të dhënave për TPM 2008 me vërtetimin e vitit 2007 tregon për një rritje të lehtë të numrit të kompanive që kanë intranet në zyrat e tyre. Në vërtetimin 2008, 66% e kompanive TPM thanë se kanë intranet, që është 8% më shumë se në 2007.

**Grafiku 13: Përdorimi i intranetit midis bizneseve të madhësive të ndryshme**




Pothuajse dy të tretat e bizneseve që u përkasin tre grupeve më të mëdha të kompanive për nga madhësia, thanë se kanë intranet në zyrat e tyre. Më pak se gjysma e bizneseve me 1-5 punonjës kanë intranet.

**Grafiku 14: Arsyet që nuk kanë akses të plotë në internet (n=49) – përgjigje e shumfishtë**




Ndër 49 bizneset që thanë se nuk kanë akses në internet 35% e tyre përmendën si arsye se “nuk kanë nevojë për internet”, 18% thanë se “nuk ka ofrues interneti në vendndodhjen e biznesit të tyre”, 14% identifikuan “koston” si arsye dhe 31% përmendën arsye të tjera.

**Grafiku 15: Përdorimi i shërbimeve bankare përmes internetit (n=297)**




Vetëm 27% e të gjithë kompanive të intervistuar përdorin shërbimet bankare përmes internetit.

**Grafiku 16: Përdorimi i shërbimeve bankare përmes internetit - 2007 TPM ndaj 2008 TPM**




Krahasimi i të dhënave të bizneseve të vrojuara në 2007 me ato të TPM në 2008 tregon për një ndryshim të lehtë, vetëm 4% rritje, në përqindjen e përdorimit të shërbimeve bankare përmes internetit.

**Grafiku 17: Përdorimi i shërbimeve bankare përmes internetit – sipas madhësisë së kompanisë**



Kompanitë e mesme dhe të mëdha prirën më shumë se kompanitë e vogla për përdorimin shërbimeve bankare përmes internetit. Vetëm 13% e kategorisë së kompanive të vogla (1-5 punonjës) përdorin shërbimet bankare përmes internetit.

**Grafiku 18: Përdorimi i shërbimeve bankare përmes internetit – “në Tiranë” ndaj “Jo në Tiranë” dhe 2007 TPM ndaj 2008 TPM**




Ka një rritje domethënëse në përdorimin e shërbimeve bankare përmes internetit nga bizneset, tatimpagues të mëdhenj, jashtë Tiranës (27% në 2008 kundrejt 13% në 2007), duke arritur nivelin e përdorimit të tatimpaguesve të mëdhenj në Tiranë. Për këta të fundit nuk ka ndryshim gjatë periudhës 1- vjeçare ndërmjet dy vrojtimeve.

## IV Sistemi Tatimor


Ky seksion fokusohet në mënyrën se si bizneset ndërveprojnë me sistemin e administratës tatimore, opinionet mbi trajtimin e tyre nga ky sistem dhe gadishmërinë për të përdorur shërbimet elektronike me administratën tatimore.

**Grafiku 19: Burimet kryesore të informacionit mbi sistemin tatimor (n=297)**




Më shumë se gjysma e bizneseve (55%) identifikojnë faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) si burim të kryesor të informacionit mbi sistemin tatimor, pasuar nga vizitat në zyrën e taksave (27%).

**Grafiku 20: Burimet kryesore të informacionit mbi sistemin tatimor -“Tiranë” ndaj “Jo në Tiranë”**




Bizneset e vendosura në Tiranë përmendin faqen e internetit të DPT (60%) pasuar nga vizitat në zyrën e taksave (21%) si burimet e tyre kryesore të informacionit mbi sistemin tatimor. Bizneset jashtë Tiranës mbështeten kryesisht në vizitat në zyrën e taksave (53%). Faqja e internetit të DPT renditet e dyta me 32%.

**Grafiku 21: Burimet kryesore të informacionit mbi sistemin tatimor - 2007 TPM ndaj 2008 TPM**




Krahasuar me vrojtimin e vitit 2007, përqindja e bizneseve tatimpagues të mëdhenj që përdorin faqen e internetit të DPT si burimin kryesor të informacionit tatimor u rrit nga 11% në 51%, duke zëvendësuar vizitat në zyrat e taksave si burimin kryesor të informacionit.

**Grafiku 22: Sa shpesh e përdorni faqen e internetit të DPT? (n=297)**




Rreth gjysma e bizneseve të intervistuar (48%) përdorin faqen e internetit të DPT të paktën një herë në javë.

**Grafiku 23: Si do ta vlerësonit cilësinë e faqes së internetit të DPT? (n=297)**




70% e bizneseve e vlerësojnë si “të mirë” dhe “shumë të mirë” cilësinë e faqes së internetit të DPT, pasuar nga 24% e bizneseve që e cilësojnë si një faqe interneti me cilësi mesatare.

**Grafiku 24: A e keni përdorur faqen e internetit të DPT gjatë tre muajve të fundit? (n=297)**




Faqja e internetit e DPT është përdorur gjatë tre muajve të fundit nga 81% e bizneseve të intervistuar.

**Grafiku 25: Mesatarisht në muaj, sa shpesh kontaktoni me zyrën e taksave? (n=297)**




Afërsisht, dy të tretat e bizneseve të intervistuar thanë se ata takohen të paktën dy herë në muaj me punonjësit e departamentit të taksave.

**Grafiku 26: Vlerësimi i marrëdhënieve me sistemin tatimor gjatë gjashtë muajve të fundit (n = 297)**



Rezultatet e vrotimit tregojnë një nivel përgjithësisht të lartë të kënaqësisë të tatimpaguesve të mëdhenj lidhur me trajtimin e tyre nga sistemi i administratës tatimore. Vetëm 9% e bizneseve që iu përgjigjën kësaj pyetje thanë se trajtimi në përgjithësi i tyre nga zyrat e tatimeve është “i pakënaqshëm”. Kategoria më e shpeshtë e përgjigjeve ishte “mirë”, pasuar nga “i kënaqshëm”. Pjesa më e madhe e përgjigjeve “i pakënaqshëm” ishte për ekzistencën në kohën e duhur të informacionit dhe cilësinë e informacionit.


**Grafiku 27: Vlerësimi i marrëdhënieve me sistemin tatimor - 2007 TPM ndaj 2008 TPM**



Përgjigjet e bizneseve të intervistuar tregojnë përmirësim në të gjitha aspektet e ndërveprimit me sistemin tatimor për grupin e bizneseve, tatimpagues të mëdhenj, në 2008, krahasuar me Vrojtimin e Nevojave të Biznesit në 2007.


Trajtimi në përgjithësi është vlerësuar “shumë mirë” dhe “mirë” nga 67% e të gjithë të intervistuarve kundrejt 42% në vrojtimin 2007. 54% e përgjigjeve për Cilësinë e informacionit janë “shumë mirë” dhe “mirë” ndaj 36% në vrojtimin 2007. Vlerësimi “shumë mirë” dhe “mirë” për Ekzistencën në kohën e duhur të informacionit arriti në 51% në vrojtimin e 2008, ndaj 37% në vrojtimin e 2007.

**Grafiku 28: “Përdorimi i faqes së internetit të DPT gjatë tre muajve të fundit” ndaj “Ekzistenca në kohën e duhur e informacionit” (n=297)**




Ato biznese që nuk e kanë përdorur faqen e internetit të DPT gjatë tre muajve të fundit prirjen të jenë pak më të pakënaqur (21% e të intervistuarve) me ekzistencën në kohën e duhur të informacionit tatar krahasuar me ata që e kanë përdorur këtë faqe (14%).

**Grafiku 29: “Përdorimi i faqes së DPT gjatë tre muajve të fundit” ndaj “Cilësia e informacionit” (n=297)**




Në mënyrë të ngjashme, një përqindje më e lartë e jo-përdoruesve të faqes së internetit të DPT ishin të pakënaqur (12%), krahasimisht me përdoruesit e kësaj faqe (10%).

**Grafiku 30: Zakonisht si e merrni informacionin në lidhje me gjendjen e llogarive tuaja tatimore? (n=297)**




Vizita në zyrën e taksave është përmendur më shpesh si mënyra për të marrë informacion mbi gjendjen e llogarisë tatimore (63% e përgjigjeve), pasuar nga shërbimi postar (14%).

**Grafiku 31: Zakonisht si e merrni informacionin në lidhje me gjendjen e llogarive tuaja tatimore? – “Tiranë” ndaj “Jo në Tiranë”**




Varësia tek vizitat në zyrën e taksave për të marrë informacion mbi gjendjen e llogarisë tatimore është më e fortë për bizneset e vendosura jashtë Tiranës (76%) se sa për ato në Tiranë (60%). Bizneset në Tiranë përdorin më shumë se bizneset jashtë Tiranës shërbimin postar (16%) dhe faqen e internetit të DPT (10%).

**Grafiku 32: Zakonisht si e merrni informacionin në lidhje me gjendjen e llogarive tuaja tatimore? - 2007 TPM ndaj 2008 TPM**




Pjesa e bizneseve tatimpagues të mëdhenj që përdorin faqen e internetit të DPT për të marrë informacion mbi gjendjen e llogarisë së tyre tatimore është rritur nga 0% në 2007 në 9% vrotimin 2008.

**Grafiku 33: Koha e shpenzuar për përgatitjen, dorëzimin e deklaratave tatimore mujore dhe pagesat e tyre (n=297)**




Më shumë se gjysma e bizneseve (59%) që morën pjesë në këtë vrojtim thanë se, mesatarisht, punonjësit e tyre shpenzojnë më pak se një ditë për të përgatitur dhe dorëzuar deklaratat tatimore mujore, ndërsa vetëm 8% thanë se punonjësit shpenzojnë më shumë se pesë ditë në muaj.

**Grafiku 34: Koha e shpenzuar për përgatitjen, dorëzimin e deklaratave tatimore mujore dhe pagesat e tyre - sipas madhësisë së kompanisë**




Sa më e madhe kompania, aq më shumë kohë duhet për të përgatitur dhe dorëzuar deklaratat tatimore mujore dhe bërë pagesat e tyre. 78% e kompanive me 1-5 punonjës përgatisin dhe dorëzojnë deklaratat tatimore dhe bëjnë pagesat brenda 8 orëve ose më pak, pasuar nga 57% e kompanive që kanë 6-20 punonjës dhe 55% e kompanive me 21-80 punonjës.

**Grafiku 35: Koha e shpenzuar për përgatitjen, dorëzimin e deklaratave tatimore mujore dhe pagesat e tyre - 2007 TPM ndaj 2008 TPM**



54% e bizneseve të grupit të tatimpaguesve të mëdhenj në vrojtimin 2008 thanë se ata i përgatisin dhe dorëzojnë deklaratat tatimore mujore në më pak se një ditë, krahasuar me 24% në vrojtimin 2007.


**Grafiku 36: “Përdorimi i faqes së DPT gjatë tre muajve të fundit” ndaj “Koha e shpenzuar për përgatitjen dhe dorëzimin e deklaratave tatimore mujore” (n=297)**



Bizneset që përdorin faqen e internetit të DPT ka më shumë të ngjarë të kursejnë kohë në plotësimin e kërkesave tatimore. 16% e bizneseve që përdoren faqen e internetit të DPT gjatë tre muajve të fundit shpenzuan më pak se 2 orë në muaj për përgatitjen dhe dorëzimin e deklaratave tatimore, ndërsa vetëm 4% e bizneseve që nuk e përdorin këtë faqe mund t'i përgatisnin dhe dorëzonin deklaratat brenda 2 orëve.


Nga ana tjetër, 38% e bizneseve që nuk e përdorën faqen e internetit shpenzuan 2 ditë ose më shumë kundrejt 20% të atyre që e përdorën faqen e internetit.

**Grafiku 37: Gjatë një viti të caktuar, sa shpesh një kompani si e juaja duhet të bëjë dhurata kur kanë të bëjnë me tatimet dhe mbledhjen e tyre? (n=297)**




19% e bizneseve të intervistuar thënë se një firmë e ngjashme me të tyre do të duhej të bënte dhuratë ose pagesë informale kur ato kanë të bëjnë me tatimet dhe mbledhjen e tyre gjatë një viti të caktuar.

**Grafiku 38: Koha e shpenzuar në vit për përgatitjen dhe dorëzimin e Bilancit Vjetor (n=297)**




73% e bizneseve të vrojtura thanë se punonjësit e tyre shpenzojnë mesatarisht një muaj ose më pak për të përgatitur dhe dorëzuar bilancin vjetor. Koha e nevojshme për të përgatitur dhe dorëzuar bilancin vjetor ka lidhje të drejtpërdrejtë me madhësinë e kompanisë. Sa më e madhe kompania, aq më shumë kohë duhet.

**Grafiku 39: Koha e shpenzuar për përgatitjen dhe dorëzimin e Bilancit Vjetor - 2007 TPM ndaj 2008 TPM**



Përqindja e bizneseve që përgatisin bilancin e tyre vjetor në një muaj ose më pak është rritur nga 59% në 2007 në 81% për grupin e bizneseve tatimpagues të mëdhenj në vërtetimin 2008.


Grafiku 40: Besimi në aftësitë e stafit në: (n=297)




Bizneset e intervistuar tregojnë një nivel të lartë besueshmërie në aftësitë e stafit të tyre për:

- përdorimin e faqes së internetit të DPT (82% thanë se kanë shumë besim),
- llogaritjen e detyrimeve tatimore (87% e bizneseve thanë se kanë shumë besim), dhe
- kuptimin e ligjeve dhe procedurave tatimore (82% thanë se kanë shumë besim).

**Grafiku 41: “Përdorimi i faqes së internetit të DPT gjatë tre muajve të fundit” ndaj “Besimi në aftësitë e stafit për kuptimin e ligjeve dhe procedurave tatimore” (n=297)**




**Grafiku 42: “Përdorimi i faqes së internetit të DPT gjatë tre muajve të fundit” ndaj “Besimi në aftësitë e stafit për të llogaritur detyrimin tatimor” (n=297)**




Sipas të dhënave në grafikët 41 dhe 42, përdorimi i faqes së internetit të DPT e rrit në mënyrë domethënëse besimin e tatimpaguesve në stafin e tyre për të kuptuar ligjet dhe procedurat tatimore dhe llogaritur detyrimin tatimor.

**Grafiku 43: A keni dëgjuar për mundësinë e kryerjes së pagesave tatimore përmes internetit? (n=297)**




95% e bizneseve të intervistuar kanë dëgjuar për mundësinë e kryerjes së pagesave tatimore përmes internetit.

**Grafiku 44: A ka marrë pjesë kompania juaj në trajnime për deklarimin tatimor përmes internetit, të ofruara nga projekti? (n= 297)**




56% e bizneseve të vrojtuar kanë marrë pjesë në trajnime mbi dorëzimin e deklaratave tatimore përmes internetit, të ofruara nga Projekti i Marrëveshjes Prag të Sfidës së Mijëvjeçarit.

**Grafiku 45: “Përdorimi faqes së internetit të DPT në tre muajt e fundit” ndaj “Pjesëmarrja në trajnime për deklarimin tatimor përmes internetit, të ofruar nga projekti” (n=297)**



Shumë më tepër biznese që kanë përdorur faqen e internetit të DPT në tre muajt e fundit kanë marrë pjesë në trajnime mbi deklarimin tatimor përmes internetit, të ofruara nga Projekti i Sfidës së Mijëvjeçarit (50% ndaj 20%).

**Grafiku 46: Numri gjithsej i pagesave të taksave, të bëra gjatë vitit të kaluar, përfshirë tatimin mbi të ardhurat, TVSH dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore (n= 297)**




Në vërtetimin e vitit 2008, 90% e bizneseve thanë se kanë bërë 49 ose më pak pagesa tatimore gjithsej gjatë vitit të mëparshëm 2007 për tatimin mbi të ardhurat e kompanisë, TVSH dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

## V Prokurimi Publik


Seksioni i mëposhtëm paraqet opinionet dhe përvojat e bizneseve të intervistuar lidhur me sistemin e prokurimit publik në Shqipëri. Pyetjet e para synojnë të marrin të dhëna mbi marrëdhëniet e kompanive me sistemin e prokurimit publik. Grupi tjetër i pyetjeve iu drejtua vetëm atyre bizneseve që kanë marrë pjesë të paktën një herë në një tender publik gjatë tre viteve të fundit ose që planifikojnë të marrin pjesë në 12 muajt e ardhshëm.

**Grafiku 47: Përqindja e të ardhurave të kompanisë që vjen nga shitjet e bëra agjencie shtetërore? (n=297)**




30% e bizneseve të intervistuar u shesin agjencie shtetërore, gjë që tregon se ato janë familjarë me sistemin e prokurimit publik në Shqipëri. 15% thanë se më shumë se 25% e të ardhurave të tyre vjen nga shitjet që u bëjnë agjencie shtetërore, ndërsa 15% thanë se kjo shifër është më pak se 25% e të ardhurave. Shumica e kompanive që bëjnë biznes me shtetin janë në sektorët e tregtisë dhe shërbimeve, pasuar nga kompanitë e ndërtimit.

**Grafiku 48: A ka marrë pjesë ndonjëherë kompania juaj në një tender publik? (n=297)**




36% e të intervistuarve thanë se kompanitë e tyre kanë marrë pjesë në një tender të paktën një herë. Nga këta, 93% kanë marrë pjesë në të paktën një tender në tre vitet e fundit dhe 55% kanë marrë pjesë në 5 ose më shumë tendera (Grafiku 49).

**Grafiku 49: Në sa tendera publike ka marrë pjesë kompania juaj gjatë 3 viteve të fundit? (n=108)**




**Grafiku 50: Burimet e informimit mbi procedurat e prokurimit publik - “Tiranë” ndaj “Jo në Tiranë” (n=297) – përgjigje e shumëfishtë**




Për bizneset e vendosura në Tiranë, faqja e internetit të APP është pa diskutim burimi më i përdorur (68%), pasuar nga Buletini i APP (31%). Për bizneset jashtë Tiranës, kjo faqe interneti dhe vizitat në zyrat shtetërore janë burimet e para të përmendura me 46% secila.

**Grafiku 51: Burimet e informimit mbi procedurat e prokurimit publik - 2007 TPM ndaj 2008 TPM - përgjigje e shumëfishtë**




Përdorimi i faqes së internetit të APP nga bizneset tatimpagues të mëdhenj është rritur nga 54% në 2007 në 65% në 2008. Përdorimi i Buletinit është ulur, ndërsa janë rritur përdorimi i Fletores Zyrtare, vizitat në zyrat shtetërore dhe mënyrat e tjera.

**Grafiku 52: A keni dëgjuar për mundësinë e prokurimit përmes internetit (n=108)**




89% e bizneseve që kanë marrë pjesë në tender gjatë tre viteve të fundit thanë se kanë dëgjuar për mundësinë e dorëzimit të dokumentave të tenderit përmes internetit. Vetëm 19% e bizneseve thanë se kanë dorëzuar dokumentat në mënyrë elektronike (Grafiku 53).

**Grafiku 53: A ka marrë pjesë kompania juaj në ndonjë prokurim përmes internetit (n=108)**




**Grafiku 54: A keni dëgjuar për Zyrën e Avokatit të Prokurimit? (n=108)**




Afërsisht  $\frac{3}{4}$  e bizneseve që kanë marrë pjesë në tendera në tre vitet e fundit janë në dijeni të ekzistencës së Zyrës së Avokatit të Prokurimit. Shumica e të intervistuarve (62%) e kanë dëgjuar këtë përmes televizionit, pasuar nga miqtë (24%) dhe gazetatat (17%) (Grafiku 55).

**Grafiku 55: Nga cili burim keni dëgjuar për Zyrën e Avokatit të Prokurimit? (n=108) – përgjigje e shumëfishtë**




**Grafiku 56: Planifikoni të merrni pjesë në një tender publik gjatë 12 muajve të ardhshëm? (n=297)**




Afërsisht 41% e të gjithë bizneseve të vrojtuar thënë se planifikojnë të marrin pjesë në një tender publik në 12 muajt e ardhshëm.

**Grafiku 57: “Pjesëmarrja në prokurim elektronik” ndaj “Planifikoj të marrë pjesë në tender publik në të ardhmen” (n=108)**




95% e bizneseve që kanë dorëzuar dokumentat e tenderave përmes internetit thënë se planifikojnë të marrin pjesë në një tender publik në 12 muajt e ardhshëm, ndërkohë që vetëm 73% e atyre që kanë dorëzuar dokumentacionin e tenderit vetëm në mënyrë jo elektronike planifikojnë të hyjnë në tendera në 12 muajt e ardhshëm. Ky rezultat tregon se Sistemi i Prokurimit Elektronik ka një ndikim pozitiv mbi pjesëmarrjen e bizneseve në prokurimet me qeverinë.

**Grafiku 58: Gadishmëria për dorëzimin e dokumentave të tenderave përmes internetit - 2007 TPM ndaj 2008 TPM**




Krahasimi i rezultateve të vërtetimit të vitit 2007 me ato të grupit të TPM për vitin 2008 tregon se ka një rritje në gatishmërinë për dorëzimin e dokumentave të tenderave përmes internetit nga 76% në 93% nga kompanitë që planifikojnë të marrin pjesë në tendera në 12 muajt e ardhshëm.

**Grafiku 59: “Pjesëmarrja në prokurim elektronik” ndaj “Gadishmëria për prokurimin elektronik” (n=83)**




Të gjitha bizneset që kanë marrë pjesë në prokurimin përmes internetit janë të gatshme të marrin pjesë në tendera në të ardhmen. 92% e atyre që planifikojnë të marrin pjesë në tendera në të ardhmen, por nuk kanë provuar përvojën e prokurimit përmes internetit, thanë se janë të gatshëm ta përdorin atë.

**Grafiku 60: Si do të dëshironit ta merrnit informacion mbi sistemin e prokurimit publik në të ardhmen? - 2007 TPM ndaj 2008 TPM - përgjigje e shumëfishtë**




Në grupin e bizneseve TPM që planifikojnë të marrin pjesë në tender në 12 muajt e ardhshëm, nuk ka ndonjë ndryshim domethënës nga vërtetimi 2007 në 2008, lidhur me preferencën për burimet kryesore të informacionit mbi prokurimin publik, faqen e internetit dhe Buletinin e APP. Sidoqoftë, ka pasur një rritje të rëndësishme për seminarët e trajnimeve nga 14% në 2007 në 29% në 2008.

**Grafiku 61: Përqindja e vlerës së kontratës që duhet paguar zakonisht në formë dhuratash me qëllim që të fitohet kontrata (n=121)**




18% e kompanive që planifikojnë të marrin pjesë në një tender publik thanë se duhet të paguhet diçka për të siguruar kontratën. 9% e të intervistuarve thanë se zakonisht duhet të paguhet më shumë se 6% e vlerës së kontratës në formën e dhuratave.

**Grafiku 62: “Pjesëmarrja në prokurim elektronik” ndaj “Përqindja e vlerës së kontratës, paguar në formë dhuratash me qëllim fitimin e kontratës” (n=83)**




90% e kompanive që kanë marrë pjesë në prokurimin përmes internetit thanë se “asgjë” nuk duhet të paguhet, po kështu pohuan edhe 78% e kompanive që nuk kanë marrë pjesë në prokurim elektronik.

**Grafiku 63: Gjatë një viti të caktuar, sa shpesh i duhet një firmë të ngjashme me tuajën të bëjë dhurata për të fituar kontrata shtetërore? (n=121)**




83% e bizneseve që planifikojnë të marrin pjesë në tendera publikë thanë se një firmë si e tyre “kurrë” nuk duhet të bëjë dhurata për të siguruar kontrata shtetërore.

**Grafiku 64: A keni marrë pjesë në trajnim për ligjin e ri të prokurimit publik? (n=121)**




26% e bizneseve që planifikojnë të marrin pjesë në njw tender publik gjatë 12 muajve të ardhshëm thanë se kanë marrë pjesë në trajnime, të organizuara, mbi ligjin e ri të prokurimit publik, ndërkohë që 24% kanë marrë pjesë në trajnime të organizuara mbi prokurimin elektronik.

**Grafiku 65: A keni marrë pjesë në trajnim për prokurimin elektronik? (n=121)**




**Grafiku 66: “Pjesëmarrja në prokurim elektronik” ndaj “Pjesëmarrja në trajnim për ligjin e ri të prokurimit publik” (n=83)**




Ndërmjet bizneseve që planifikojnë të marrin pjesë në prokurimin elektronik në 12 muajt e ardhshëm, 47% thanë se kanë marrë pjesë në trajnime të organizuara mbi ligjin e ri të prokurimit publik. Krahasimisht, vetëm 27% e bizneseve që nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në prokurimin elektronik kanë ndjekur trajnime.

**Grafiku 67: “Pjesëmarrja në prokurim elektronik” ndaj “Pjesëmarrja në trajnim për prokurimin elektronik” (n=83)**



**Grafiku 68: Përse nuk planifikoni të merrni pjesë në tendera publike? (n=176) - përgjigje e shumëfishtë**




Arsyet kryesore më të përmendura për të mos marrë pjesë në tendera publike në 12 muajt e ardhshëm ishte se *nuk realizojmë/ prodhojmë ato që mund të blihen nga qeveria* (44% e të intervistuarve). Gjithashtu, 24% e të intervistuarve thanë se *tenderimi është një proces i komplikuar dhe merr shumë kohë*, po aq sa thanë se *punojmë me kapacitet të plotë dhe shesin gjithçka tek klientet privatë*. Arsyet e tjera, megjithëse të përmendura më pak, janë ato rreth ndershmërisë dhe efikasitetit të sistemit të prokurimit. Arsyeja se *fitimi nuk është i mjaftueshëm në kontratat me qeverinë* u përmend nga vetëm 11% e të intervistuarve, por duhet theksuar se përgjigja *operojmë me kapacitet të plotë* mund të konsiderohet si një përgjigje alternative për fitime të ulta nga biznesi me agjencitë shtetërore kundrejt atyre nga sektori privat.

## VI Regjistrimi i Biznesit


Ky seksion i vrotimit fokusohet në çështjet që lidhen me regjistrimin e biznesit.

**Grafiku 69: Gadishmëria për regjistrimin e biznesit përmes internetit (n=297)**




Niveli i gadishmërisë për regjistrimin e biznesit përmes internetit është i lartë. 75% e bizneseve janë “shumë të gatshëm” dhe 16% janë “deri diku të gatshëm” ndaj kësaj ideje. Pjesa tjetër thanë se “nuk janë të gatshëm” ose janë “të pasigurtë” rreth kësaj procedure të re.

**Grafiku 70: Gadishmëria për regjistrimin e biznesit përmes internetit - 2007 TPM ndaj 2008 TPM**




Ndërmjet bizneseve, tatimpagues të mëdhenj, të vrotuar, gadishmëria për regjistrimin e biznesit përmes internetit është rritur nga viti 2007 (68% thanë se ishin “shumë të gatshëm”) në 2008 (81% “shumë të gatshëm”).

**Grafiku 71: A keni dëgjuar për QKR? (n=297)**



Shumica e bizneseve të intervistuar (96%) thanë se kanë dëgjuar për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

**Grafiku 72: Sa do të ishit të gatshëm të paguani për çdo transaksion që QKR të vazhdojë të kryerjé shërbimin brenda një dite? (n=297)**



Pothuajse 56% e bizneseve të intervistuar thanë se janë të gatshëm të paguanjë 200 Lekë ose më shumë për çdo transaksion, me qëllim që të sigurohet vazhdimësia e shërbimit brenda një dite. Sidoqoftë, vetëm 7% thanë se do të ishin të gatshëm të paguanin 1,000 Lekë ose më shumë. (Tarifa aktuale për çdo transaksion është 100 Lekë).

